



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

FTESË PËR NEGOCIATA

Mbështetur në VKM nr. 1195, datë 05.08.2008, “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve apo të reklamave për trasmetim nga operatorët radio televiziv ose botim në median e shkruar dhe për kontratat për kohë transmetimi nga organet e administratës shtetërore”, në VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 374, datë 2.7.2025 “Për disa shtesa në vendimin nr. 150, datë 6.3.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2025”,

Objekti i programit/spotit/reklamës: Informimi mediatic i publikut lidhur me masat e mbështetjes për skemën kombëtare të investimeve, për vitin 2025

Nevoja për kryerjen e reklamave: Me anë të kësaj fushate komunikimi do të bëhet i mundur realizimi i objektit: “Për informimin e publikut për skemën kombëtare të investimeve, për vitin 2025”, dhe marrja e informacionit në të gjithë territorin e vendit.

Të zhvillohet procedura e blerjes, zhvillimit dhe prodhimit të spotiteve/reklamave: “Për informimin mediatic të publikut të gjerë, lidhur me implementimin e masave të mbështetjes për skemën kombëtare të investimeve, për vitin 2025” si “ndërtimin e serrave, mbjelljet e reja të pemëve frutore, rrjeta për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri, sistemet e ujitjes me pika, ndërtimin e ambienteve të reja për mbarështimin e kafshëve dhe të stabilimenteve për rritjen e shpendëve, mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore e blegtorale, linja/makineri/pajisje për përpunimin, seleksionimin, paketimin dhe etiketimin e perimeve, frutave, rrushit dhe verës, ullirit dhe vajit të ullirit, investime në agroturizëm, akuakulturën detare për koshat e rritjes së peshkut (vetëm për koshat dhe rrjetat)”, me fond limit 12,022,613.8 (dymbëdhjetë milion e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e trembëdhjetë pikë tetë) lekë pa TVSH.

Ideimi i spoteve/video informuese të kryhet nga organet e masmedia të specializuara në këtë fushë dhe transmetimi të kryhet nga masmedia on-line, publikim në 4 gazeta, 1 (një) Spot i përgjithshëm për Skemën Kombëtare 2025 për publikim në radio, Video Graphic 20 (10 Video promovuese për fushatën e aplikimeve dhe 10 Video historitë e suksesit), 20 Inforgrafikë informuese, Fletëpalosje me QR Code, Banner grafik për kryefaqen e web-it zyrtar dhe mediave sociale (facebook, instagram) të AZHBR, Printim Roll Up, Printim Posterash, Organizimi i takimeve informuese në 12 qarqe.

Objekti i programit të spoteve/reklamave për sektorët që do të mbështeten, nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, është rritja e kapaciteteve të prodhimit në ferma, nëpërmjet mbështetjes së investimeve për:

- ndërtimin e serrave;
- mbjelljet e reja të pemëve frutore;
- rrjeta për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri;
- sistemet e ujitjes me pika;
- ndërtimin e ambienteve të reja për mbarështimin e kafshëve dhe të stabilimenteve për rritjen e shpendëve;
- mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore e blegtorale;
- linja/makineri/pajisje për përpunimin, seleksionimin, paketimin dhe etiketimin e perimeve, frutave, rrushit dhe verës, ullirit dhe vajit të ullirit;
- investime në agroturizëm;
- akuakulturën detare për koshat e rritjes së peshkut (vetëm për koshat dhe rrjetat).

TEKSTI DHE KONTENTI

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall thirrjen për aplikime nga fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2025.

Bazuar në VKM nr. 374, datë 2.7.2025 “Për disa shtesa në vendimin nr. 150, datë 6.3.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2025”, sektorët që do të mbështeten dhe masa e financimit për vitin 2025, janë si më poshtë vijon:

Mbështetje për investime për:

a) ndërtimin e serrave diellore të reja për perime, luleshtrydhe dhe rrush tavoline, përfshirë edhe instalimin e sistemit të ujitjes, me sipërfaqe minimale 0.2 ha dhe sipërfaqe maksimale 2 ha. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se:

- 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë/ha për serrat e prodhimit të perimeve;
- 8 000 000 (tetë milionë) lekë/ha për serrat e prodhimit të rrushit për tavolinë;
- 4 000 000 (katër milionë) lekë/ha për serrat (tunelet plastike) të prodhimit të luleshtrydheve.

b) mbjelljet e reja të pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe vreshtave. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0,5 ha dhe jo më shumë se 10 ha. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 800 000 (tetëqind mijë) lekë/ha. Përfitojnë pagesë shtesë fermerët që instalojnë sistemet e ujitjes me pika. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha.

c) rrjeta për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri në blloqet ekzistuese me pemë frutore, agrume dhe vreshta. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se

1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 5 (pesë) ha.

ç) sistemet e ujitjes me pika në pemëtore, ullishte, agrume dhe vreshta ekzistuese. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 10 ha.

d) ndërtimin e ambienteve të reja për mbarështimin e kafshëve dhe të stabilimenteve për rritjen e shpendëve, përfshirë pajisjet/sistemet e nevojshme, me kapacitet jo më pak se 10 (dhjetë) lopë, jo më pak se 100 (njëqind) të imëta, jo më pak se 10 (dhjetë) dosa dhe jo më pak se 10 000 (dhjetë mijë) shpendë. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë për subjekt.

dh) mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore e blegtorale. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt.

e) linja/makineri/pajisje për përpunimin, seleksionimin, paketimin dhe etiketimin e perimeve, frutave, rrushit dhe verës, ullirit dhe vajit të ullirit në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 7 500 000 (shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë për subjekt.

ë) investime në agroturizëm me një masë përfitimi në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë 15 000 000 lekë (pesëmbëdhjetë milionë) për subjekt.

f) akuakulturën detare për koshat e rritjes së peshkut (vetëm për koshat dhe rrjetat). Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë për subjekt.

Informacioni i nevojshëm për mënyrën e aplikimit, kriteret e përfitimit dhe procedimit deri në përfitimin e mbështetjes financiare gjendet pranë Agropikave, pranë Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Zyrave Qendrore të AZHBR si dhe në faqen e internetit: www.azhbr.gov.al dhe www.mbzhr.gov.al.

Procedura e blerjes, zhvillimit dhe prodhimit të spoteve/reklamave: “Për informimin e publikut për skemën kombëtare të investimeve, për vitin 2025”, do të zhvillohet sipas specifikimeve teknike të më poshtme:

1. **Publikimi i Skemës Mbështetëse të Investimeve**, për vitin 2025, në median e shkruar minimumi 4 gazeta të përditshme, kohëzgjatja 10 ditë.
2. **Reklamim në rrjete sociale (facebook dhe instagram)** audienca e synuar është 100.000 përdorues në ditë, dhe frekuenca e shfaqjes të jetë 2 herë në ditë.
3. **Reklamim Radio:**
 - prodhim i 1 spoti radiofonik;

- transmetimi i spotit radiofonik në minimumi 4 radio konkretisht (1 kombëtare, 3 lokale) duke mbuluar gjithë teritorin e vendit dhe të vendoset theksi që të informohen sa më shumë zonat rurale në vend;
- frekuenca jo më pak se 4 (katër) herë në ditë, jo më pak se 30 sekonda.

Monitorimi i transmetimit në radio, do të kryhet nga një shoqëri e specializuar.

4. Video Grafik

➤ Video promovuese për fushatën e aplikimeve:

- 10 Video (motion graphic) 1 video për secilën masë, për përdorim në rrjete sociale;
- gjatësia e video graphic të jetë 30-60 sekonda secila;
- me sfond muzikor dhe voiceover (nëse kërkohet);
- të përmbajë imazhe grafike shpjeguese për thirrje për aplikim në masat kombëtare të investimeve 2025;
- videot duhet të përmbajnë sloganin kryesor, logon zyrtare të AZHBR, MBZHR, si dhe adresën e internetit përkatës.
- Produkti final duhet të jetë format video MP4, HD (horizonta+vertikal) për rrjetet sociale, si dhe duhet të dorëzohet në format digital CD ose USB.

➤ Video historitë e suksesit:

- 10 Video (motion graphic) 1 video për secilën masë, për përdorim në rrjete sociale;
- gjatësia e video graphic të jetë 30-60 sekonda secila;
- me sfond muzikor dhe voiceover (nëse kërkohet);
- të përmbajë imazhe grafike të fermerëve dhe agrobizneseve të mbështetura nga skema kombëtare e investimeve , si dhe rolin e investimeve dhe impaktin në fermë/biznes ;
- videot duhet të përmbajnë sloganin kryesor, logon zyrtare të AZHBR, MBZHR, si dhe adresën e internetit përkatës.
- Produkti final duhet të jetë format video MP4, HD (horizonta+vertikal) për rrjetet sociale, si dhe duhet të dorëzohet në format digital CD ose USB.

Afati i dorëzimit, maksimumi 5 ditë nga kërkesa me shkrim e AZHBR.

5. Infografikë Informuese:

- Sasia: 20 infografikë
- Temat e propozuara:
 - Si të aplikosh në Skemën Kombëtare (hap pas hapi)
 - Çfarë mbështet masat e skemës?
 - Kriteret e përzgjedhjes dhe vlerësimit
 - Afatet dhe dokumentacioni
 - FAQ (Pyetje të Shpeshta), (përmasa, kriteret, afatet) - Minimumi 10 pyetje të

- shpeshta

Afati i dorëzimit, maksimumi 5 ditë nga kërkesa me shkrim e AZHBR.

6. Fletëpalosje me QR Code:

- **Formati:**
 - katër faqe, 5000 (pesë mijë) copë ;
 - 4 ngjyra ;
 - Letër 115 gr.
- **Përmbajtja :**
 - Prezantim i skemës ;
 - Masat, përfituesit, mënyra e aplikimit;
 - Kontaktet dhe linku i ëeb me QR Code;

7. Poster (banner) grafik për kryefaqen e web-it zyrtar dhe mediave sociale (facebook, Instagram) të AZHBR:

- dizajn me ngjyra;
- logo e AZHBR, MBZHR;
- përmasa sipas parametrave të dritares në faqen zyrtare dhe mediave sociale AZHBR.

8. Printim Roll up:

- 8 copë ;
- përmasat 80 cm x 200 cm ;
- Material banner + mekanizëm përkatës ;
- Roll up do të përmbajë dizajn.

9. Printim posterash:

- 1 (një) faqe, 50 copë;
- 4 ngjyra;
- letër 115 gr;
- formati A3.

10. Organizimi i takimeve informuese me fermerë për aplikime në skemën mbështetëse të investimeve 2025 me të dhëna/specifikime si më poshtë:

- takime informuese në 12 (dymbëdhjetë) qarqe të Shqipërisë: Tiranë, Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Berat, Vlorë, Elbasan, Korçë, Dibër, Gjirokastrë dhe Kukës:

- shërbimi kërkohet të jetë në ambient të hapur (outdoor) ose të mbyllur (indoor);
- Vendndodhjet e eventit;
- të jetë për 70-100 persona të ulur (karrike të disponueshme);
- të ketë të instaluar sistem audio, projektor, pajisje të nevojshme si dhe të ofrohen dhe dy mikrofona valor, për diskutime nga të pranishmit;
- asistencë teknike gjatë gjithë takimit.

Termet e referencës

1. Fletëpalosje me QR code

- Operatori merr përsipër të krijojë, tekstin dhe layout-in grafik të fletëpalosjeve;
- Fletëpalosja duhet të përmbajë slogan tekst logo;
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për fletëpalosjen;
- Fletëpalosja duhet të përmbajë logon e AZHBR MBZHR;

Afati i dorëzimit, maksimumi 5 ditë nga kërkesa me shkrim e AZHBR.

2. Rroll up 1 -*Thirrje për aplikim*

- Përmbajtja: Financime për fermerë, agropërpunues dhe agrobiznese, masat për agroturizëm, blegtori dhe teknologji bujqësore ;
- Vizual: Foto fermerësh në fushë, logo AZHBR.

3. Rroll up 2 -*Përfitimet dhe procedurat*

- Përmbajtja: Përfitimet nga masat e skemës (përmirësim teknologjie, pajisje, infrastrukturë), hapat kryesorë të aplikimit, kontaktet dhe afatet e aplikimit
- Vizual: Infografikë e thjeshtuar me hapa, ikona dokumentesh, foto fermash të suksesshme.
- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin tekstin dhe layout grafik të posterit, me kompozim ;
- Roll up do të përmbajë 1 dizajn;
- Roll up duhet të përmbajë slogan tekst logo;
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik;
- Roll up duhet të përmbajë logon e AZHBR MBZHR.

Afati i dorëzimit, maksimumi 5 ditë nga kërkesa me shkrim e AZHBR.

3. Postera:

- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin, tekstin dhe layout grafik të posterit, me kompozim të ndryshëm për masat mbështetëse ;

- Posterit duhet të përmbajë fotografi, slogan, tekst ;
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për posterin ;
- Posterit duhet të përmbajë logon e AZHBR, MBZHR.

Afati i dorëzimit, maksimumi 5 ditë nga kërkesa me shkrim e AZHBR.

4. Organizimi i aktiviteteve:

- Aktivitetet do të zhvillohen gjatë muajit korrik-shtator 2025.
- Operatori ekonomik merr përsipër transportin e materialeve të përcaktuara sa më sipër si karrige, banner, stafin e promocionit, etj;
- Operatori ekonomik merr përsipër organizimin e aktiviteteve përkatëse sipas specifikimeve teknike.

Të paraqitet një projekt ide-skenar për realizimin e shërbimit në CD ose hardcopy.

Fondi limit është 12,022,613.8 (dymbëdhjetë milion e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e trembëdhjetë pikë tetë) lekë pa TVSH.

➤ Dokumente ligjore që duhen paraqitur, si kriter kualifikues:

- Ekstrakt historik i QKR, që vërteton se Operatori Ekonomik ushtron aktivitet ekonomik tregtar që përputhet me objektin e procedurës dhe është aktiv;
- Vërtetim që ka paguar detyrimet tatimore koherente;
- Vërtetim të xhiros vjetore të realizuar gjatë 3 viteve 2023-2024-2025;
- Vërtetim për numrin e punonjësve për periudhën Janar 2025-Korrik 2025;
- Vetëdeklarim mbi gjendjen gjyqësore, ku shprehet se, operatori ekonomik nuk ka ndjekje penale, si dhe nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata, që lidhet me aktivitetin profesional.

➤ Dokumentacioni financiar, si kriter kualifikues

- Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë bankare së bashku me nr. IBAN;
- Kontratë të ngjajshme të realizuar gjatë tre viteve të fundit me shtetin (referencë ose kontratë) dhe/ose me subjekte private (faturat përkatëse dhe/ose kontrata);
- Sigurimin e ofertës në masën 2% të vlerës së fondit limit;
- Deklaratën që subjekti nuk është në konflikt interesi;
- Deklaratën që i përmbush specifikimet dhe termat e referencës;
- Deklaratë konfidencialiteti;
- Formularin e ofertës;

- Media plan paraprak për shpërndarjen/transmetim;
- Deklaratë nga operatori ekonomik që transmetimi i reklamës do të jepet nga organet e medias, të cilat janë aktive dhe të licensuara sipas legjislacionit në fuqi.

Dokumentacioni të jetë origjinal ose kopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

Kriteret e vlerësimit të subjekteve janë :

Vlerësohet me 35 (tridhjetë e pesë) pikë -> Projekt-ideja e realizimit të spoteve/reklamave, e cila përmban idejim/krijim;

Projekt ideja do të vlerësohet nga Komisioni, në varësi të projekt idesë më të mirë të paraqitur.

Vlerësohet me 30 (tridhjetë) pikë -> Koha radiofonike e blerë për transmetimin e Spoteve/reklamave (sipas logjikës së formulës më poshtë).

KR - Koha radiofonike

KRM - Koha radiofonike me e madhe

KRV - Koha Radiofonike e që vlerësohet

$$KR = \frac{30 * KRV}{KRM}$$

Vlerësohet me 35 (tridhjetë e pesë) pikë-> oferta më e ulët ekonomike në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta (sipas logjikës së formulës më poshtë).

OE- Oferta ekonomike

OU- Oferta më e ulët

OV- Oferta që vlerësohet

$$OE = \frac{35 * OU}{OV}$$

Vlerësimi përfundimtar = pikët për projekt idenë + pikët për kohën televizive + pikët për ofertën ekonomike.

Oferta duhet të jetë origjinale si dhe dokumentacioni i kërkuar më sipër duhet të jenë të futur në zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën tuaj.

Mbi zarf të jetë shënuar **“Ftesë për Negociatë”**. Përzgjedhja e ofertave do të realizohet sipas VKM nr. 1195, datë 5.8.2008, dhe kriterve të përshkruara dhe metodologjisë me sistemin e pikëve.

Monitorimi i publicitetit do të kryhet sipas përcaktimeve që do të vendosen në kontratën e shërbimit ndërmejt palëve.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë AZHBR në datën **29.7.2025, ora 15:00**.

Komisioni pret konfirmimin nga operatorët ekonomik për vazhdimësinë e negociatave, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociata.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë jashtë këtij afati dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Pas analizimit të ofertave, të paraqitura nga organet e masmedias/agjencitë e specializuara, komisioni përzgjedh, në bazë të pikëve, organet e masmedias/agjencitë e specializuara, duke u bazuar në kushtet e veçanta, të përcaktuara.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ardita Kuçi